

## AKT – THEMELIMI

### SHOQERISE “AA MULTI COMPOSITE” SHPK

Shpallur sot më datë 03/02/2017 Ortaku :

Znj. Blerta Lefteri e bija e Andon-it e dl.01.03.1974, lindur ne Elbasan dhe banuese ne lagjen “Jeta e Re”-Durres, me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut themelues te shoqerise me perjegjesi te kufizuar “ AA MULTI COMPOSITE ” sh.p.k. identifikuar me Karte Identiteti me Nr. 028941265 dhe Nr.H45301308C.

E cila bazuar në Ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i modifikuar) dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, shpallin sa vijon:

#### NENI 1 THEMELIMI I SHOQERISE

Ortaku themelues, **Blerta lefteri** themelon Shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar “AA MULTI COMPOSITE” SH.P.K.

Shoqëria, themeluar me inisiativën e ortakut themelues, konsiderohet e themeluar në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëngjitur këtij akti.

Shoqëria i nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do ti nënshtrohen legjislacionit të vëndit ku do të ketë qendrën dega.

Degët e shoqërisë do të ushtrojnë veprimtarinë në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie dhe brënda kompetencave që do tu jenë dhënë me aktet e krijimit apo me akte të tjera të veçanta.

#### NENI 2 SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në Durres me adresë: **Selia e shoqerise eshte ne adrese: Lagjia Nr.14, Rruga”Asti Nushi”, shkozet-Durres, ZK:8516, Godine me Nr.Pasuri 4/53, Durres**

Shoqëria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me aprovin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

#### NENI 3 E DREJTA

Shoqëria “AA MULTI COMPOSITE ” SH.P.K. është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakut që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje

dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi si Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar) e në përputhje dhe në zbatim të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartëpërmëndura.

NENI 4  
PERGJEGJESIA

Shoqëria vepron në rregjin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiakë për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimtaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

NENI 5  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "**AA MULTI COMPOSITE**" SH.P.K. ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Prodhime pjesesh te ndryshme plastike per automjete, barka, pjesë industriale, montim dhe prodhim i varkave turistike si dhe mjetet e tjera te lundrimit, veshje dhe mobilim i barkave, shtepive, prodhim kende-lojtrash ujore dhe tokesore, i aksesoreve te çative, kjoskave te levizhme apo jo, i koshave te plehrave dhe aksesoreve te tyre etj.
- Regjim i perpunimit aktiv ne fushen e produkteve plastike.
- Import – Eksport i mallrave industriale dhe ushqimore, prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice i tyre.
- Trasport mallrash dhe udhetaresh si dhe sherbime per vete dhe per te tretet brenda dhe jashte vendit.
- Pjesmarrje ne shoqeri te tjera me objekt veprimtarie te ngjashme.
- Krijimin e axhensive doganore, detare, turistike, etj.

NENI 6  
KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë "**AA MULTI COMPOSITE**" shpk është deri më 31 dhjetor 2060.



NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestar i shoqërisë eshte 100.000 (njeqindmije) lekë dhe përfaqësohet nga kontribute në para.

Ky kapital i përket kontributit të ortakut themelues i cili përfaqëson 1 kuote ne vleren 100.000 leke

Kapitali fillestar i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 8  
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Asambleja e Ortakëve e "AA MULTI COMPOSITE" SH.P.K është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Asambleja e Ortakëve thirret nga administratori, ortak themelues i shoqërisë, ose dhe nga ortakët e shoqërisë sipas nenit 84 të ligjit të cituar.

Vendimet e Asamblese së Ortakëve merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo rast që është e nevojshme mbrojtja e interesave të shoqërisë.

Administrimi i shoqërisë realizohet nga administratori i saj **Znj. Blerta Iefteri**, ortake themeluese e shoqërisë, e cila emërohet për një afat jo më të gjatë se 5 vjet dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të Zakonshme.

NENI 9  
TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Ortakët kanë të drejta dhe detyrime të barabarta ndaj ligjit.

NENI 10  
BAZA LIGJORE PER NDRYSHIMET

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, administratorin, kapitalin, selinë, ortakët, objektin e veprimitarisë etj., sipas vendimit që do të merret nga Asambleja e Ortakëve dhe sipas kërkesave të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar).

NENI 11  
BILANCI

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë do të mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti. Viti ushtrimor do të përkojë me vitin kalendarik. Vetëm për vitin e parë ushtrimor do të kihet parasysh periudha që shtrihet nga momenti i rregjistrimit në organin tatimor deri në datën 31 dhjetor.

NENI 12  
FITIMI

Të ardhurat neto të shoqërisë (fitimi) do të ndahen midis ortakëve në mënyrë proporcionale me kuotat përkatëse që ata disponojnë.

NENI 13  
OBJEKTIVAT

Paraprakisht, ortakët nuk ndajnë detyrat dhe që të gjithë së bashku do të duhen të bashkëpunojnë për të realizuar zhvillimin e një aktiviteti eficent të shoqërisë.

NENI 14  
PERFAQESIMI

E drejta për të përfaqësuar shoqerinë para çdo organi shtetëror, privat, bankar dhe gjyqësor ushtrohet nga Administratori i Shoqërisë ose nga një person tjetër i autorizuar me prokurë nga administratori.

NENI 15  
REZERVA LIGJORE E NDRYSHIMEVE

Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi, prandaj, çdo ndryshim i këtij akti do të detyrojë ortakët të bëjnë ndryshimet përkatëse në mënyrë për t'ia përshtatur kërkesave ligjore.

NENI 16  
ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Akt dhe në Statut, vlejnë dispozitat e Ligjit Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligjit n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar).

NENI 17  
JURIDIKSIONI GJYQJESOR

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi midis ortakëve dhe personave të tretë do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit ku ka seline ligjore shoqeria.

NENI 18  
STRUKTURA E KONTRATES

Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë do të janë pjesë përbërëse të strukturës së kontratës së shoqërisë.

NENI 19  
VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Akti i themelimit hartohet në katër kopje origjinale, pasi u lexua dhe u gjend konform vullnetit të lirë të dy ortakëve themelues, nënshkruhet rregullisht prej tyre para noterit.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Blersa Leffeni

## STATUTI I SHOQËRISË

“AA MULTI COMPOSITE” SH.P.K.

### KREU I

### EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA, AKTIVITETI, PARIMI I DETYRIMIT TE BESNIKËRISË

#### NENI 1

#### EMËRTIMI I SHOQËRISË DHE ORTAKET E SHOQERISE

Shoqëria emërtohet “AA MULTI COMPOSITE” shpk. Ajo është person juridik dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, me Statutin dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

**Blerta Lefteri** e bija e Andon-it e dl.01.03.1974, lindur ne Elbasan dhe banuese ne lagjen “Jeta e Re”-Durres, me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut themelues te shoqerise me perjegjesi te kufizuar “AA MULTI COMPOSITE” sh.p.k. identifikuar me Karte Identiteti me Nr. 028941265 dhe Nr.H45301308C

#### NENI 2 SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë është në Durres me adresë: **Selia e shoqerise eshte ne adresë: lagjia Nr.14, Rruga”Asti Nushi”, shkozet-Durres, ZK:8516, Godine me Nr.Pasuri 4/53, Durres.** Shoqëria do të ketë edhe vënd qëndrime të tjera të dyta, filiale dhe përfaqësi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe, me aprovin e organeve kompetente edhe jashtë tij.

#### NENI 3 KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “AA MULTI COMPOSITE” SH.P.K. është deri më 31 dhjetor 2060.

#### NENI 4 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "AA MULTI COMPOSITE" shpk. ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Prodhime pjesesh te ndryshme plastike per automjete, barka, pjese industriale, montim dhe prodhim i varkave turistike si dhe mjetete te tjera te lundrimit, veshje dhe mobilim i barkave, shtepive, prodhim kende-lojrash ujore dhe tokesore, i aksesoreve te çative, kjoskave te levizshme apo jo, i koshave te plehrave dhe aksesoreve te tyre etj.
- Regjim i perpunimit aktiv ne fushen e produkteve plastike.
- Import – Eksport i mallrave industriale dhe ushqimore, prodhimin dhe tregtimin me shumice dhe pakice i tyre.
- Trasport mallrash dhe udhetaresh si dhe sherbime per vete dhe per te tretet brenda dhe jashte vendit.
- Pjesmarrje ne shoqeri te tjera me objekt veprimtarie te ngjashme.
- Krijimin e axhensive doganore, detare, turistike, etj.
- 

NENI 5  
E DREJTA

Shoqëria "AA MULTI COMPOSITE" SH.P.K është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakëve që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislativit shqiptar në fuqi si Ligji 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Ligji n. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i modifikuar) e në përputhje dhe në zbatim të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë të përditësuar në përputhje me ligjet e lartëpërmëndura.

NENI 6  
PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

Gjatë ushtrimit të të drejtave ortakët e shoqërisë veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorin e shoqerise.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR,  
ANULLIMI I KUOTAVE, E DREJTA E PRONËSISË SË SHOQËRISË, ADRESA E  
ORTAKËVE, VULA E SHOQËRISË

NENI 7  
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestar i shoqërisë eshte 100.000 (njeqindmije)lekë dhe përfaqësohet nga kontribute në para.

Ky kapital i përket kontributit të ortakut themelues i cili përfaqëson 1 kuote ne vleren 100.000 leke

Kapitali fillestare i shoqërisë do të mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### NENI 8

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit mund të shiten nga ortakët e shoqërisë me vleren nominale ose sipas një vlere tjetër të pranuar midis shitësit dhe blerësit. Shitia e kuotave duhet të jetë në përputhje me kuotat e poseduara nga ortakët dhe ju bëhet e njojur me akt të shkruar dhe regjistruar në rregjistrin e shoqërisë.

#### NENI 9

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE TË TRETEVË

Kuotat e kapitalit themeltar mund tu transferohen lirisht personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri nese ky vendim është i aprovuar nga ortakët që përfaqësojnë totalisht të paktën 51% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 10

#### TRANSFERIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI

Kuotat e kapitalit, në rast vdekjeje i kalojnë trashëgimtarëve duke hyrë këta të fundit në shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut.

#### NENI 11

#### ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

Mund të proçedohet në anullimin e kuotave mbi të gjitha kur sjellja e ortakut është pengesë në kryerjen e aktivitetit dhe detyrave statutore të shoqërisë. Në këtë rast, ortakut i likuidohet megjithatë vlera e kuotës te tij dhe kuotat e tij u ndahen ortakëve të tjera që bëjnë kërkësë në mënyrë gjithmonë proporcionale me kuotat e kapitalit që tashmë disponojnë.

#### NENI 12

#### PËRGJEGJËSIA E SHOQËRISË

Shoqëria vepron në rregjin e pronës private dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime.

Shoqëria përgjigjet me pasurinë e saj për detyrimet e saj kontraktore dhe jashtë kontraktore ndaj të tretëve. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve në veçanti, por për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Ortakët nuk përgjigjen me pasurinë e tyre vetiakë për detyrimet e shoqërisë që vijnë nga veprimitaria që kryejnë në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët.

#### NENI 13

#### ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve përsa i përket marrdhënieve të tyre me shoqërinë është ajo e regjistruar në librin e ortakëve themelues të shoqërisë e cila mund te përditësohet. Do te jeteë detyrim i ortakëve të komunikojnë me shkrim me anë të rekomandesë me lajmërim marrje që vërteton dorëzimin efektiv në një vendbanim te ndryshem nga ai i deklaruar me parë. E njejtë procedurë do të zbatohet për çdo përditësim të mëtejshëm.

NENI 14  
VULA E SHOQËRISË

Shoqëria ka vulën e saj me të njëtin emërtim si vetë shoqëria. Përdorimi i vulës është i rezervuar eksluzivisht administratorit, me përashtim të nje ortaku tjetër që të jetë posaçërisht i deleguar.

KREU III

ASAMBLEJA E ORTAKËVE, E DREJTA E VOTËS, PROÇESVERBALET E  
MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË ORTAKËVE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË,  
DETÝRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

NENI 15  
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

Asambleja e Ortakëve e **"AA MULTI COMPOSITE" shpk** është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë që përbëhet nga të gjithë ortakët.

Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e per gjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut, mund t'i drejtojne administratorit nje kerkese me shkrim, perfshire posten elektronike per te thirrur Asamblene e Pergjithshme dhe/ose perfshirjen e çeshtjeve te posacme ne rendin e dites. Keresa duhet te permbate arsyet, objektivat dhe çeshtjet per te cilat Asambleja duhet te marre vendim.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

\* Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori/ët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund

të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

\* Mbledhja e Asamblese eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortaket qe zoterojne me shume se 30% te kuotave, per te vendosur per çeshtje te zakonshme. Ne kete rast, vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga shumica e ortakeve pjesemarres, ( e cilesuar ne kete statut si "shumice e thjeshte").

\* Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme realizohet per te vendosur per ceshtje te veçanta si: Ndryshimi i Statutit, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te regjistruar, shperndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqerise, eshte e vlefshme nese ne te marrin pjese ortake qe zoterojne me shume se 50% te kuotave. Ne kete rast vendimi i Asamblese eshte i vlefshem nese eshte votuar nga jo me pak se 3/4(tre te katertat) e votave te ortakeve pjesemarres (e cilesuar ne kete statut si "shumice e kualifikuar").

\* Mbledhja e Asamblese se Ortakeve drejtohet nga Administratori nese eshte e thirrur prej tij. Nese Mbledhja e Asamblese se Ortakeve eshte thirrur nga pakica, atehere ajo kryesohet nga njeri prej ortakeve i zgjedhur nga pjesemarresit ne ate mbledhje. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën 2 herë në vit.

\* Asambleja e Përgjithshme thirret në çdo rast që është e nevojshme mbrojtja e interesave të shoqërisë.

\* Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara, me përashtim të rastit kur blerjet kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme te shoqërisë në kushte normale tregu.

\* Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

\* Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur ne kete menyre, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 16  
E DREJTA E VOTËS

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote duke kuptuar me shprehjen "cdo kuote" posedimin e të paktën të një vlere 1% te kapitalit te shoqerise. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjese në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjeter; c) mekanizma, që mundësojnë

procesin e votimit, përpala apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: a) vlerësimin e veprimtarisë së tij; b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### NENI 17

#### PROÇESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në proçesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme. Proçesverbal duhet të përmbajë datën dhe vedin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Proçesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i proçesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të proçesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

#### NENI 18

#### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i shoqërisë realizohet nga administratori i saj **Znj. Blerta Lefteri**, ortake themeluese e shoqërisë, e cila emërohet për një afat jo më të gjatë se 5 vjet dhe ushtron përfaqësimin e shoqërisë. Konkretnisht, administratori ka të drejtë e detyrohet të: a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare; c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilançin vjetor, bilançin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala asamblesë së përgjithshme për miratim; d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; e) raportojnë përpala asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin

e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të Zakonshme.

#### NENI 19

#### DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

Administratori, përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të këtij ligji, detyrohet: a) të kryejë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; b) të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; ç) të parandalojë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji; dh) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mos veprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme: a) u kthen ortakëve kontributet; b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë; c) u shpérndan aktivet shoqërisë; ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; d) jep kredi.

#### NENI 20

#### PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria "AA MULTI COMPOSITE" shpk me përgjegjësi të kufizuar prishet: a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; b) me vendim të asamblesë së përgjithshme; c) me hapjen e procedurave të falimentimit; ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; d) me vendim të gjykatës; dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

NENI 21  
LARGIMI I ORTAKËVE

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas paragrafit te pare te këtij nenit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kérkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria.

NENI 22  
PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kérkojë gjykatës

përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortaku: a) me dashje apo me pakujdesi të rënde shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërrkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kérkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.

Shoqëria ka të drejtë t'i kérkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kérkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kérkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi,

ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e vendimit të formës së prerë të gjykatës përjashtimin. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

NENI 23  
LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KREU IV  
ZBATIMI I LIGJIT

NENI 24  
ZBATIMI I LIGJIT

Përsa nuk është parashikuar në këtë Statut vlejnë dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 25

Ky akt u redaktua në kater kopje për tju shpërndarë ortakeve dhe organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**

BLERTA LEFTERI



Dok 03.02.2017